

PRANIA E DANTES NË VEPRËN POETIKE DHE ESTETIKËN E T. S. ELIOTIT

Dr. Manjola Nasi

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
E-mail: manjola.nasi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ky punim ka për qëllim të japë një panoramë dhe të bëjë një analizë të përgjithshme në lidhje me ndikimin e jashtëzakonshëm të Dante Alighierit në krijimtarinë dhe mendimin letrar të Tomas Sterns Eliotit, një nga emrat më të rëndësishëm jo vetëm në poezinë, por edhe në mendimin letrar të shekullit të njëzetë. Elioti ka shkruar tri ese për poetin italian: “Dante”, e vitit 1920, “Dante” e vitit 1929 dhe “Ç’rëndësi ka Dantja për mua” (“What Dante means to me”) e vitit 1950. Gjithashtu, ai e ka përmendur Danten në një sërë kontekstesh të tjera të kritikës dhe mendimit të tij letrar. Ajo çka është më e rëndësishmja, në veprën letrare të Eliotit, përdorimi i aluzioneve, por edhe koncepteve teorike që mund të shihen si të frymëzuara nga vepra e Dantes përfshihet në të gjitha fazat e krijimtarisë eliotiane dhe është tejet i larmishëm në formë, intensitet dhe rolin që i caktohet në secilin pasazh apo vepër.

Ndikimi, ky fenomen në vetvete sa i natyrshëm dhe i pashmangshëm, aq edhe me raste dëmtues e gjymtues, bëhet edhe më interesant në rastin e Eliotit, për dy arsye: e para ka të bëjë me poezinë e tij, rëndësinë, risitë dhe specifikat e saj. Megjithatë nuk do të ishte e arsyeshme dhe as e mundur të bënim një këqyrje shtruese, mënyrat si e ka ndikuar Dantja Eliotin si poet do të shikohen këtu për llojin, shtrirjen dhe thellësinë e tyre, duke u përqendruar shkurt te raste nga më të rëndësishmet. Arsyja e dytë pse është interesant ky ndikim, ka të bëjë me konceptet estetike dhe letrare të Eliotit, si me mënyrën si ai e shihte nocionin thelbësor të traditës letrare, të cilat do të trajtohen në këtë punim për të ilustruar rëndësinë e Dantes në mendimin dhe veprën e Eliotit.

Fjalët çelës: letërsi, poetikë, estetikë, mendimi letrar

ABSTRACT

This article aims to provide a general overview and analysis on the profound influence of Dante Alighieri on the literary work and criticism of Thomas Stearns Eliot – one of the most prominent names not only in XX century poetry, but also in the literary theory and criticism of his time. Eliot wrote three essays about the Italian poet: “Dante”, published in 1920, “Dante” written in 1929, and “What Dante Means to Me” published in 1950. Additionally, he referenced Dante in a series of other contexts in his criticism and literary essays.

Most significantly, in Eliot's literary oeuvre, the use of allusions and theoretical concepts that may be seen as inspired by Dante's work spans throughout the different stages of Eliot's literary career, and manifests in diverse forms, intensities, and roles, within each fragment or work.

Influence, a phenomenon as natural as it is unavoidable and, at times damaging and crippling, becomes even more noteworthy in Eliot's case for two reasons. The first pertains to his poetry, its importance, novelty, and structural specifics. While it is not feasible to provide an exhaustive overview here, the ways in which Dante's influence can be observed in Eliot's poetry will be seen here with regard to its kinds, extent, and depth, concentrating briefly on some of the most important instances. The second reason why this influence is intriguing relates to Eliot's aesthetic and literary notions, as well as his perspective on the crucial concept of literary tradition, which will be explored in this article with the aim of illustrating Dante's importance in Eliot's criticism and literary work. Keywords: literature, poetics, aesthetics, criticism

1. Hyrje

Rëndësia e Dantes në veprën e Eliotit është shumëplanëshe dhe e vështirë për t'u trajtuar në mënyrë shteruese. Kjo ndodh për disa arsye: e para, që ajo nuk mund të përkufizohet lehtësisht as si teorike, as si strukturore, as si përmbajtësore, pasi në të vërtetë është një gërshetim i pandashëm i çdonjërës nga këto aspekte; e dyta, sepse natyra e kësaj marrëdhënieje kaq komplekse është thellësisht e ndryshme nga njëra fazë e eseistikës dhe veprës letrare të Eliotit, dhe e treta, sepse duke qenë të dy poetë kaq të rëndësishëm, kaq eruditë, kaq të rrënjësuar në kulturën e brezit dhe vendit të vet dhe njëkohësisht kaq universalë e të gjithëkohshëm, me raste bëhet e pamundur që ky ndikim të shikohet si i drejtpërdrejtë, apo i prejardhur nga të njëjtat burime historike, letrare e kulturore.

Vetë Elioti shprehet se "Askush nuk ka pasur ndikim më të madh tek unë se Dantja".¹ I ndërgjegjshëm për këtë, ai i kushton poetit italian tri ese të rëndësishme gjatë gjithë karrierës së tij krijuese, si edhe përdor aluzione, ndërtekstualitet, simbole e figura të shumta nga "Komedia hyjnore" në poezitë e tij. Me anë të këtyre eseve, por sidomos me anë të rasteve më të rëndësishme ku ndikimi shfaqet në veprën e tij, mund të këqyrim natyrën e kësaj marrëdhënieje, po edhe të kuptojmë se si tradita, të cilës i përket edhe Dantja, është përdorur në mënyrë kaq të efektshme nga Elioti, sa të vendoset në thelb të gjithë zhvillimeve mbresëlënëse që ai krijoi në poezinë e shekullit XX e më pas.

1. Cituar nga Manganiello, Dominik. (1989) *T. S. Eliot and Dante*. New York, St. Martins, f. 1.

2. Tradita për Eliotin

Për Eliotin, tradita letrare është një ndër çështjet më të rëndësishme si të mendimit të tij teorik dhe kritik, ashtu edhe të veprës së tij, në të cilën ai e vuri në praktikë në mënyrë tejet origjinale dhe që mandej u shndërrua në elementet më thelbësore të risisë që paraqiti poezia e tij në përgjithësi e për sa i përket ndikimit të vetë atij në modernizmin letrar.

Këtu do të trajtohet shumë shkurtimisht ky koncept, të cilin ai e shpjegoi fillimisht në esenë “Tradita dhe talenti individual”, botuar në 1919. Një pasazh i kësaj eseje thotë:

“Tradita është një çështje me rëndësi të madhe. Ajo nuk mund të trashëgohet dhe nëse e do, duhet ta fitosh me shumë punë. Pikësëpari, në të përfshihet sensi historik, [...] [i cili] ka të bëjë me perceptimin e të kaluarës jo vetëm si e kaluar, por edhe si e tashme; ai e shtyn njeriun të shkruajë [...] me ndjesinë se gjithë letërsia e Europës qysh nga Homeri dhe brenda saj e gjithë letërsia e vendit të tij ka ekzistencë të njëkohshme dhe përbën një rend të njëkohshëm. Ky sens historik, që është ndjesia e të pakohshmes dhe e kohores, si dhe e të pakohshmes dhe kohores së bashku, [...] e mpreh ndërgjegjësimin e shkrimtarit për vendin e tij në kohë, për kohën në të cilën jeton.”²

Duket qartë që ky nuk është konceptimi i zakonshëm i traditës, sipas të cilit tradita përshkruhet si diçka e së kaluarës që vjen në ditët e mëvonshme si një tërësi përjetimesh e arritjesh që, me gjithë vlerën dhe atë që përfaqëson, mund të zgjidhet të përfshihet në të tashmen letrare në formën e vet, ose të përdoret si një stad evolutiv i mëparshëm, mbi të cilën do të ndërtohet një qenie e re, më e avancuar mundësisht, po sidoqoftë, qartësisht e shkëputur prej saj në një mënyrë a një tjetër.

Ndërsa, siç shihet në citimin e mësipërm, Elioti e shikon atë si të njëkohëshme. Ai shprehet se njohja e traditës dhe pranimi i njëkohësisë së saj, e bën shkrimtarin më të ndërgjegjshëm për kohën dhe kontekstin e vet.

Shkrija kohore mes së tashmes dhe së shkuarës e vendos traditën në pozicion shumë të ndryshëm nga mënyra si e kuptojmë zakonisht. Këndvështrimi i Eliotit nuk përqendrohet tek ajo si diçka që ka ekzistuar dikur dhe që ka mbaruar, por te kontributi i saj në arritjet

2. Eliot, T. S. (1932). “Tradition and the Individual Talent”. *Selected Essays*. London. Faber and Faber Ltd. f.14.

e kohës sonë. Në këtë kuptim, tradita është pjesë e çfarëdo vepre, fushe njohurish apo veprimtarie njerëzore. Procesi i zhvillimit kalon nëpër përpjekjet e shumë brezave dhe mosnjohja e rrugës që ata kanë përshkuar është të humbësh një përparësi mjaft me vlerë. Për këtë, kur flet për “fitimin [e traditës] me shumë punë”, Elioti e ka fjalën te të qenët i ndërgjegjshëm për çdo hap që është hedhur, gjë që ai e etiketon si “sensi historik”.

Por këtu shohim dy këndvështrime që në plan të parë duken kundërthënëse. Nga njëra anë, ai shprehet:

“Dikush tha: ‘Shkrimtarët e vdekur janë shumë larg nga ne, sepse ne dimë shumë më tepër se ata.’ Pikërisht. Dhe ata janë ajo që dimë.”³

Si edhe:

“Nëse i afrohem poetit pa paragjykime, shpesh do të shohim se pjesët jo vetëm më të mira, por edhe më origjinale të veprës së tij mund të jenë ato në të cilat poetët e vdekur, paraardhësit e tij, e përforcojnë pavdekësinë e tyre më fuqishëm.”⁴

Por nga ana tjetër, thotë:

“Nëse e vetmja formë e traditës, e trashëgimisë, do të ishte ndjekja e rrugëve të brezit të mëparshëm duke iu përkushtuar në mënyrë besnike e të verbër arritjeve të tij, atëherë ‘tradita’ duhet të hidhet poshtë. Kemi parë shumë rryma të tilla të thjeshta të humbin e të zhduken; dhe risia është më e mirë se përsëritja.”⁵

Pra, për çfarë e ka në thelb fjalën Elioti, kur flet për njëkohësinë e traditës, praninë dhe vlerat e saj nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër e quan dëmtues rolin e saj si autoritet i padiskutueshëm modelesh, temash e formash?

Një mënyrë për ta përshkruar shkurt nga ana teorike se për çfarë flet ai, është *dictum*-i i Ezra Paundit, figurë gjithashtu e rëndësishme për

3. Ibid., f. 16.

4. Ibid., f. 14.

5. Ibid., f. 14.

Eliotin, sidomos në fazën e parë të veprës dhe mendimit të tij, që thotë: “Make it new” – bëje të re. Që tradita të mos bëhet bllokuese, mbytëse, tharmi i saj duhet të mbryhet në veprën e re në mënyrë që të krijohet një shije e re, një bukë që e mbart atë, e pranon atë dhe ndërtohet prej saj në një evolucion të natyrshëm dhe të nevojshëm, pra, me pak fjalë, t’i nënshtrohet një shndërrimi.⁶ Duke parë raste specifike të ndikimit të Dantes te vepra poetike e Eliotit, kuptohen më qartë disa nga mënyrat sesi mund të ndodhë një gjë e tillë. Dhe sigurisht, për të bërë këtë, vlen ajo që Elioti e thotë në një tjetër ese të tij, “Filip Masinxhër”, ku ai vëren se në rastet kur procesi i shndërrimit të lëndës së traditës nuk ndodh, ajo e humb vetinë për të ndihmuar në gjenerimin e risisë dhe efekti i saj është i dëmshëm. Në këtë ese, Elioti thotë shprehjen e tij të shumëcitur:

Një nga provat më të sigurta [për nivelin e poetit] është mënyra si poeti merr hua. Poetët e papjekur imitojnë; poetët e këqij i masakrojnë ato që marrin dhe poetët e mirë i kthejnë në diçka të mirë, ose së paku, në diçka të ndryshme. Poeti i mirë e shkrin vjedhjen e tij për të formësuar një ndjenjë të re që është unike, tërësisht e ndryshme me atë nga e shkëputi; poeti i keq e ngjesh atë që ka marrë në diçka ku nuk përputhet. Poeti i mirë zakonisht merr hua nga autorë të largët në kohë, ose të huaj në gjuhë, ose të ndryshëm në interes.⁷

Megjithëse i largët në kohë dhe i huaj në gjuhë, Dantja nuk ishte fort i ndryshëm nga Elioti në interesa. Në njëfarë mënyre, vepra letrare dhe mendimi teorik e kritik i Eliotit përmbushin atë që thuhet te “Tradita dhe talenti individual” për ndikimin e të resë mbi të vjetrën, duke qenë se shumë nga trajtimet teorike dhe zbatimet praktike të konceptit të traditës te Elioti, shërbejnë deri diku për të rikuptuar atë që ndodh te “Komedia Hyjnore”.

Kështu, nisur nga një ndjenjë me origjinë thellësisht personale dhe të udhëhequr nga parime të ngjashme në lidhje me historinë, besimin fetar, sensin e të drejtës, të dy këta poetë, në kohë dhe në mënyra të ndryshme, janë burim thellësisht i pastër dhe i rrënjosur

6. Shiko: Bloom, Harold. (1997) *The Anxiety of Influence: A Theory of Poetry*. New York: Oxford U. Press, f. 15-26.

7. Eliot, T. S. (1932) “Philip Massinger” në *Selected Essays*. London: Faber & Faber, f. 206.

mirë në kohën dhe brezin e tyre,⁸ i arritjeve të jashtëzakonshme estetike të formës e përmbajtes. Në të njëjtën mënyrë, Dantja e mbruji traditën ekzistuese, figurat e saj të ardhura nga historia, letërsia, mitologjia në veprën e tij, pa i shpërfytyruar ato, po edhe pa e humbur kohezionin e projektit të tij artistik për shkak të kësaj polifonie historish, ngjarjesh e personazhesh. Për këto arsye, Elioti i cakton ngjashëm Dantes një vend kaq thelbësor në poezinë e tij, çka do të këqyret më nga afër në vijim.

3. Dantja në trajtimet teorike

Në tri esetë e shkruara për Danten [“Dante”, e vitit 1920, “Dante” e vitit 1929 dhe “Ç’rëndësi ka Dantja për mua” (“What Dante means to me”) e vitit 1950], Elioti e vlerëson nga këndvështrime të ndryshme Danten në vetvete dhe në kuadër të ndikimit që ai kishte në veprën dhe mendimin e Eliotit. Nëse në dy esetë e para ai përpiket ta përkufizojë Danten si poet e mendimtar, te më e çiltra nga të gjitha, eseja e vitit 1950, “Ç’rëndësi ka Dantja për mua”⁹ Elioti shpjegon, ashtu siç arrin ta kuptojë ai, mënyrat konkrete si ka ndikuar poeti fiorentin në veprën e tij.

Ai trajton me detaje e shembuj konkretë proceset sesi lënda danteske është përkthyer në veprën e tij në mënyrë të ndërgjegjshme në lëndë të re, sipas përkufizimit teorik të traditës sipas tij, duke folur për huazim (pra, citim të drejtpërdrejtë), imitim, përshtatje, por pastaj shpjegon se borxhi më i rëndësishëm që mund t’i ketë një poet Dantes nuk qëndron as te huazimet, as te përshtatjet, as te pasazhet ku ka shërbyer si model, as citimet e drejtpërdrejta, madje as te ndikimi i mendimit të tij, pikëpamjeve për jetën, atyre filozofike apo teologjike që i kanë dhënë formë “Komedisë hyjnore”. Për Eliotin, ky borxh qëndron pikësepari në ato që poeti “mëson dhe vazhdon të mësojë” nga Dantja. Sipas tij, kjo përmbledhet në tri pika, ose tri mësimet të mëdha: e para, që Dantja i kushtonte rëndësi artit të poezisë si askush tjetër më parë ose më pas, që ai, në vend që ta vinte gjuhën në shërbim të tij, e shihte veten si shërbëtor të gjuhës; e dyta, që Dantja kishte arritur të eksploronte, të nxirrte në pah dhe të emërtonte një spektër të pashoq emocionesh për nga gjerësia, duke u dhënë bashkëkohësve dhe lexuesve të tij emër për

8. Shiko: Eliot, T. S. (1932) “Seneca in Elizabethan translation”, *Selected Essays*. London: Faber & Faber, f. 96. dhe “Shakespeare and the Stoicism of Seneca”, po aty, f. 136-137, 139.

9. Eliot, T. S. (1991) “What Dante Means to Me”, *To Criticize the Critic and Other Writings*. New York: Farrar, Straus and Giroux Incorporation, f. 13.

gjëra që nuk kishin mundësi t'i emërtonin, e ndoshta as t'i ndjenin më parë; Elioti quan mësim të tretë të rëndësishëm të Dantes faktin sesi ai është *më europiani* ndër poetët, por që prapëseprapë nuk e arrin këtë gjë duke mohuar kombësinë apo veçoritë e tij lokale, pasi, sipas Eliotit, Dantja është në të njëjtën kohë më lokali ndër poetë.

Në këtë rast, përveç atyre që thotë Elioti, bëhet i qartë një fakt që në mënyra të ndryshme përmended edhe te dy esetë më të hershme që ai ka shkruar për Danten: që të gjitha këto shkallë ndikimi ekzistojnë tek ai dhe te vepra e tij, duke variuar nga abstraktja, te konkretja, por vlerësimi si mësimet më të rëndësishme bëhet mbi të gjitha jo për faktin se shkallët e tjera të ndikimit janë më pak të rëndësishme, por sepse Elioti e ndiente që, në njëfarë mënyre, në këto tri mësimet ai kishte ende për të mësuar nga poeti i vjetër.

Në mënyrë të përsëritur, Elioti përpiqet ta përkufizojë Danten edhe për larushinë e kontributeve të tij letrare, por edhe për atë që ai përfaqëson në sistemin e madh të traditës letrare, duke e krahasuar vazhdimisht me të tjerë poetë, shkrimtarë, teologë, filozofë dhe duke e nxjerrë thuajse gjithmonë fitues, nga çfarëdo këndvështrimi.

Megjithëse të njëjtën strategji ai e ndjek në shumë nga diskutimet e tij joletrare për shumë autorë bashkëkohorë e të së kaluarës, në asnjë rast tjetër nuk duket se përcaktimi i një lloji hierarkie letrare bëhet kaq prioritar për të. Dhe pas shumë shqyrtimesh, te eseja "Dante" e vitit 1929 duket se i jep një përgjigje të vendosur gjithë kësaj beteje mendore: "Dantja dhe Shekspiri e ndajnë botën moderne mes tyre; dhe nuk ka të tretë."¹⁰

Detajet tek të cilat është përqendruar në mënyrë të hollësishme në të dyja esetë "Dante", ku trajtohet njëkohësisht edhe vepra, edhe mendimi dantesk, edhe estetika e "Komedisë hyjnore" e "Vita Nuova", marrin në njëfarë mënyre një rishikim dhe përmbledhje të eseja e tretë në vitin 1950, kohë në të cilën Elioti ishte tashmë në kulmin e karrierës së tij poetike dhe arrinte ta kuptonte edhe më mirë cila pjesë e Dantes ishte më e fuqishmja dhe me e përsëritshmja.

Por mbi të gjitha, përtej dimensionit të krishterë të Dantes, i cili i korrespondonte dimensionit të krishterë të vetë Eliotit, përtej tri mësimëve të mëdha që ai identifikon te eseja e tretë, përtej gjithë imitimeve, citimeve, e vetë përkufizimeve filozofike e teologjike, Elioti duket se gjen te Dantja një lloj frymëzimi për të kërkuar të arrijë me

10. Eliot, T. S. (1932) "Dante" në *Selected Essays*. London: Faber & Faber, f. 265.

veprën e vet një shkrimje unike forme e përmbajtjeje. Në këto tri ese, Elioti po kërkon të përkufizojë Danten aq sa edhe ambicjen e vet krijuese. Por sigurisht, për rëndësinë e tij në traditën letrare dhe ndikimin që ka ai vetë si poet, për shumëkë rëndësia e kësaj marrëdhënieje qëndron më së pari në mënyrën si vepra e tij merr ushqim nga vepra e Dantes, çka do ta shikojmë për ilustrim në vazhdim.

4. Prania e prekshme në veprën e Eliotit

Debutimi i Eliotit në skenën e poezisë së shkruar anglisht u bë në vitin 1915, kur në numrin e qershorit të revistës së rëndësishme letrare "Poetry" u botua një poezi me titullin "Këngë dashurie e Xh. Alfred Prufrokt". Mes gjithë vlerësimeve, kjo poezi është përshkruar në mënyra emfatike si poezia në të cilën Elioti shpiku modernizmin, dhe pranohet gjerësisht si kryevepra e parë e modernizmit në gjuhën angleze. Rëndësia e kësaj poezie qëndron jo vetëm për atë që thotë e nënkupton, po edhe për teknikat rrëfimore, ndërtimin dhe strukturën e saj.

Pikërisht në këtë fazë kaq të hershme të karrierës poetike të Eliotit dallohet për herë të parë forca e rolit të Dantes te krijimtaria e tij. Për rrjedhim, këtë poezi duam të shfrytëzojmë, përveç se për qëllime ilustruese në gjatësinë e kufizuar të këtij artikulli, edhe për t'u përqendruar te një ndikim interesant i Dantes, i cili pavarësisht rolit që luan në kontekstin origjinal të "Komedisë hyjnore", shndërrohet te Elioti në një element sa përmbajtësor, ashtu edhe strukturor.

Kështu, pas titullit të saj që premtonte një këngë dashurie, poezia vazhdon me një tekst që i nuk i shkon fort për shtat këtij emërtimi. Prufroku, uni rrëfimtari i poemës, e paraqet veten mes kaosit urban, i rrethuar nga njerëz, figura historike e letrare, ndërveprime të kota, të cekëta dhe një atmosfere të zhytur në mjegull, mugëtirën e mbrëmjes, zhurmën e bisedave boshe, në frikëra, përqeshje, vetmi dhe në fund zhgënjim dhe vdekje. Kalimi nga titulli te ky tekst, kalon përmes një pikete të rëndësishme strukturore: epigrafit.

S'io credesse che mia risposta fosse
A persona che mai tornasse al mondo,
Questa fiamma staria senza piu scosse.
Ma perciocche giammai di questo fondo
Non torno vivo alcun, s'i'odo il vero,
Senza tema d'infamia ti rispondo.

*(S'do dridhej flaka ime, s'do bëzaja,
në qoftë se do ta dija që n'atë botë
ti kthehesh prap, po mbasi nga hataja
e fundit t'ferrit, nga e tmerrshmja shqotë,
nuk doli kush i gjallë të shpëtojë zjarri,
turpin pa e drashtë, gjegje pa jap të plotë.)¹¹*

Epigrafi përbëhet nga strofat 21 dhe 22 të Këngës së 27-të të Ferrit. Njësoj si edhe në epigrafe të tjerë të Eliotit, ky epigraf luan rol thelbësor në çdo aspekt të poezisë, merret i pandryshuar nga origjinali, madje i papërkthyer dhe shërben si një urë jo vetëm mes vargjeve dhe veprës së re, po edhe mes kontekstit të origjinalit dhe veprës së re. Duke thirrur në ndihmë poetin fiorentin, Elioti po thërret shpirtin e gjithë veprës së tij.

Funksioni dhe efekti i vargjeve të epigrafit përmbushet siç duhet vetëm nëse lexuesi e njeh kontekstin origjinal të fragmentit, pra "Ferrin" e Dantes. Në rrethin e tetë të ferrit, Dantja, në funksionin e udhëtarit protagonist, takon Guido da Montefeltron, i cili ia drejton këto fjalë para se t'i rrëfejë sekretin e mëkatit që e ka degdisur në atë skëterrë.

Më thjesht, fjalët e tij do të kishin kuptimin: "Unë e di se ti je i dënuar të rrih këtu në ferr si unë, përgjithmonë, ndaj po ta besoj sekretin tim. Nëse ti do të kishe mundësinë të ikje prej këtej, unë nuk do të të tregoja asgjë".

Një tjetër aspekt po kaq i zymtë, është fakti që rrjedh nga analogjia se poema i besohet lexuesit vetëm ngaqë ai, njësoj si vuajtësi kryesor, është në ferr. Ashtu siç ndodh edhe në kontekstin dantesk, vargjet janë pohim i situatës së përbashkët dhe të pashmangshme. Megjithëse Dantja, në cilësinë e protagonistit, është në dijeni të fakteve të tjera që e dallojnë prej të dënuarve, te "Komedia hyjnore" këto vargje shërbejnë për të rritur efektin dramatik të burgimit të pashpresë që pësojnë personazhet.

Së treti, atmosfera që zë fill pikërisht në epigraf për të vazhduar në të gjithë poemën, është pesha e një sekreti që nuk mund të thuhet, çka krijon ndjesinë e bllokimit të komunikimit, të cilin vetë Prufroku e përjeton si pasojë e pamundësisë apo paaftësisë për t'u shprehur. Kur

11. Alighieri, D. dhe Gjeçi, P. (2009). *Komedia Hyjnore*. Tiranë, Argeta LMG, f. 161.

Prufroku përshkruan zbrazëtinë e ndërveprimeve njerëzore me stilin e tij të fragmentuar deri në kufijtë e inkoherencës si pasojë e përdorimit të teknikës së përroit të ndërgjegjes, bota e tij hapet para syve të lexuesit me gjithë vetminë me të cilën e mbështjell personazhin.

Së fundi, analogjia më e zbehtë mund të pikaset në përqasjen satirike të kësaj poezie me “Komedia hyjnore” në përgjithësi: të dy protagonistët nisen në kërkim të dashurisë dhe të dyve u duhet të përshkojnë terrene shumë të vështira. Njësoj si te rasti i “Uliksit” të Xhojsit përballë “Odisesë” të Homerit, udhëtimi i Prufrokut është shumë më pak heroik se i Dantes. Piketat e veprës së parë janë të pranishme vetëm pjesërisht dhe shkarazi, pasi forca e personazhit të Dantes zëvendësohet nga ngurrimi dhe paraliza e protagonistit eliotian, i cili në fund nuk ia arrin qëllimi me sukses, por bëhet pre e mbytyjes figurative, që ka gjasa të nënkuptojë dorëheqjen.

Në thelb, ky rast i përdorimit të drejtpërdrejtë të vargjeve nga Komedia Hyjnore, përbën një rast të shndërrimit të lëndës poetike, siç shprehet Elioti te esetë që diskutuam më herët.

Është me vlerë të vërehet si tek Elioti, përmbajtja nuk është asnjëherë e ndarë nga struktura, ndaj është thuajse gjithmonë delikate ta përshkruash një element si më të rëndësishëm në rrafshin strukturor, apo përmbajtësor. Paralelizmi ose edhe kontrastet që krijojnë aluzionet shtrihet jo vetëm mes pjesëve të një vepre të Eliotit, duke u dhënë atyre kohezion dhe ndërlidhje që në pamje të parë duket se nuk ekziston, në saje të “marrjes borxh” të strukturës apo kohezionit të veprës origjinale, po madje edhe zhvillohet nga njëra vepër në tjetrën, duke sjellë në lojë aluzione të dyfishta, pra në njërën anë i referohet veprës origjinale, si në rastin konkret “Komedia Hyjnore”, dhe nga ana tjetër, veprave të mëparshme të Eliotit ku janë përfshirë aluzione nga e njëjta vepër.

Për ta bërë konkrete këtë ide, desha të përqendrohem shumë shkurt tani në mbyllje te një imazh i përgjithshëm që shfaqet përsëri e përsëri në gjithë kohështrirjen e veprës poetike të Eliotit: imazhi i njerëzve që vërtiten në ferr. I rishfaqur në thuajse të gjitha veprat e tij, ai është një imazh që zgjerohet ngadalë dhe pasurohet me çdo rishfaqje, thuajse gjithmonë me lëndë të parë të marrë nga Komedia Hyjnore. Kështu, gratë që venë e vijnë nëpër dhomë dhe flasin për Mikelanxhelon te Prufroku, janë po aq infernale, aq të paprekshme, aq të ajërta, sa edhe turma te Toka e Shkretë, për të cilën aluzioni nga Komedia është mëse i qartë dhe i shprehur nga Elioti te shënimet që i bashkëngjiten poemës:

Qyteti Joreal

Nën mjegullën ngjyrëkafe të një mëngjesi dimri

Një turmë vërshoi mbi Urën e Londrës, aq shumë

S'kisha menduar që vdekja të kish zhbërë aq shumë.

(“Varrimi i të vdekurit”, “Toka e Shkretë”, 60 – 63)

Këtu vargu “S’kisha menduar që vdekja kish zhbërë aq shumë”, që te Komedia në shqip Pashko Gjeçi e përkthen “T’besoj se vdekja kaq shumë kishte çartun”, vjen nga kënga e tretë e ferrit.

Ndërsa te poezia “Njerëzit e zbrazët”, ky imazh pasurohet në mënyrë të papritur, duke u përzier me një element tejet të ndryshëm, trëndafilin dantesk:

Në vendtakimin tonë të fundit

Mbërthehemi pas njëri-tjetrit

Pa folur

Mbledhur në bregun e lumit të fryrë

Të verbër, përveç kur

Sytë shfaqen prapë

Si ylli i përjetshëm

Trëndafili fletëshumë

I mbretërisë së muzgut të vdekjes

E vetmja shpresë

E njerëzve bosh.

(“Njerëzit e zbrazët”, 57 – 67)

Kontrasti mes trëndafilin dhe turmës infernale, njësoj si paralelizmi në raste të tjera, plotëson këtë imazh dhe rishfaqja e tij krijon një rrjet të ndërlikuar strukturor që i shërben veprës së Eliotit duke i dhënë asaj mundësinë as më pak, as më shumë, po të përmbajë, të gllabërojë madje, brenda saj veprën e poetit që jetoj shekuj para tij.

Këto janë shkurtimisht disa nga format që ndikimi i Dantes bëhet i dukshëm te Elioti, dhe e njëjta gjë ndodh tek ndikimi i Eliotit mbi Danten, po të ndjekim logjikën e asaj që thotë Elioti te “tradita dhe talenti individual”, që edhe e reja e ndikon të vjetrën si anasjelltas.

Dhe në fakt, kushdo që e rilexon Danten pasi ka lexuar Eliotin, do të ndiejë sikur edhe pak gjurmët e veprës së re mbi atmosferën e veprës së vjetër.

Përfundime

Ndikimi i Dante Aligerit në mendimin teorik dhe krijimtarinë poetike të T. S. Eliotit është i pakundërshtueshëm dhe jo fort i vështirë për t'u dalluar. Ajo që bëhet e vështirë është që ky ndikim të shikohet përkundër ideve të ndërlikuara të Eliotit, si edhe të trajtohet karshi skemave të tij tejet komplekse strukturore e përmbajtësore në poezitë e tij, në të gjitha fazat e krijimtarisë poetike.

Në këtë artikull, ky ndikim u analizua si në esetë e Eliotit, ashtu edhe në poezitë e tij, duke u përpjekur të trajtohet roli i jashtëzakonshëm që poeti italian pati mbi thuajse gjithë elementët e rëndësishëm të veprës poetike e kritike të Eliotit, i cili, në motivacionin e dhënies së Çmimit Nobel, u cilësua nga Akademia Suedeze si “një nga pasardhësit më të vonë të Dantes”.

Po të nisemi nga koncepti eliotian i traditës, kjo marrëdhënie kaq komplekse është dyfish e rëndësishme: jo vetëm ngaqë kemi kontributin ndikues të Dantes mbi veprën e tij, çka në njëfarë mënyre ka “përkthyer” poetin e vjetër në gjuhën, ndjeshmëritë dhe stilin e jetesës së shekullit XX, po edhe ngaqë Elioti, me ritrupëzimin e elementeve danteske në veprën e vet, na e ripërkufizon Danten, duke i dhënë atij një tjetër vlerë të re, atë të të qenit i gjithëkohshëm në një mënyrë të pasuruar me këtë vepër të re, me të cilën bashkëjeton në traditën më të mirë letrare.

BIBLIOGRAFIA

- ALIGHIERI, D. dhe GJEÇI, P. (2009) *Komedia Hyjnore*. Tiranë, Argeta LMG.
- BLOOM, Harold (1997) *The Anxiety of Influence: A Theory of Poetry*. New York, Oxford U. Press.
- ELIOT, T. S. (1991) “What Dante Means to Me”, *To Criticize the Critic and Other Writings*. New York, Farrar, Straus and Giroux Incorporation.
- ELIOT, T. S. (1932) *Selected Essays*. London. Faber and Faber Ltd.
- MANGANIELLO, Dominik (1989) *T. S. Eliot and Dante*. New York, St. Martins.
- MILLER Jr., JAMES E. (2005) *T. S. Eliot: The Making of an American Poet, 1888 – 1922*. United Kingdom, Penn State Press.
- SCOFIELD, Martin (1988) *T. S. Eliot, The Poems*. Cambridge, Cambridge University Press.